



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.351/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjetit politik Alternativa, me seli në Gjakovë, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, me shenjën ZL.Anr.351/2017 e dates 22.10.2017, me të cilën ka kërkuar që ti shqiptohet dënimi me gjobë subjetit politik Alternativa, me seli në Gjakovë, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 22.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, me të cilën ka pretenduar se me datë 22.10.2017, afër Qendrës së Votimit 0205C, në oborrin e shkollës fillore “Zekria Rexha”, është vendosur posteri i kandidates për kryetare të Kuvendit Komunal të Gjakovës nga subjekti politik Alternativa, Mimoza Kusari Lila.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik ALTERNATIVA ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 36 par. 1 pika a) dhe b) të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur dy fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektivit politik ALTERNATIVA, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe të pabazura në ligj, sepse nga fotografit të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk mund të identifikohen objektet mbrapa fotografisë se në ditën e votimit janë duke u përdorur si qendra të votimit. Me këtë rast paneli vlerësoi, se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e

ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në ankesë në mënyrë që paneli, të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuar më lartë e duke bazuar nenin 115, 117 dhe neni 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
ZL. Anr.351/2017 më datën 24.10.2017



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform neni 118.4 të LZP-së.